



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 204, Datë 27.06.2023

MBI

**MBI PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “SOLE 24
DOOEL SHKUP–DEGA NË SHQIPËRI” DEGË E SHOQËRISË SË HUAJ, NË
VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 64, pika 2, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.06.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1433/12 prot., datë 23.06.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi përfundimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “SOLE 24 DOOEL Shkup–Dega në Shqipëri”, Degë e shoqërisë së huaj, për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike dhe njohjen e licencës për ushtrimin e veprimtarisë së furnizimit dhe tregtimit energjisë elektrike, dhënë nga Komisioni Rregullator i Energjisë dhe Shërbimeve të Ujit i Republikës së Maqedonisë së Veriut, për subjektin “SOLE 24 IMPORT-EKSPORT DOOEL SHKUP”,

Konstatohet se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 182, datë 29.05.2023, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “SOLE 24 DOOEL SHKUP–Dega në Shqipëri”, Degë e shoqërisë së huaj, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 30.05.2023 dhe 31.05.2023), si dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s, dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 08.06.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla.
- Me shkresën nr. 1432/2 prot., datë 30.05.2023, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe dokumentacionin e konstatuar të munguar apo të plotësuar pjesërisht.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1433/4 prot., datë 05.06.2023, shoqëria paraqiti kërkesë dhe dokumentacion për njohjen e licencës për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, të lëshuar nga Komisioni Rregullator i Energjisë dhe Shërbimeve të Ujit i Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke argumentuar se në mungesë të informacionit mbi mundësinë e njohjes së licencës sipas Rregullores për licencimin, ka dërguar fillimisht në ERE kërkesën përkatëse për marrjen e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
- Me shkresën nr. 1433/6 prot., datë 15.06.2023, ERE iu drejtua shoqërisë me kërkesën për saktësim të objektit të saj, në rast se kërkon nga ERE procedimin me njohjen e licencës, në mënyrë që të vijohet sipas përcaktimeve ligjore me procedurën e nisur për licencim.
- Me e-mailin e protokolluar në ERE me nr. 1433/9 prot., datë 21.06.2023, shoqëria ka saktësuar se kërkon anulimin e procedurës së nisur për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike dhe vijimin e procedurës përkatëse për njohjen e licencës.
- Për sa parashikuar në nenin 64, pika 2, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, në rrethanat kur ERE nuk ka marrë ende një vendim përfundimtar mbi aplikimin e shoqërisë për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike dhe shoqëria ka shprehur kërkesën e saj për t’u tërhequr nga kjo kërkesë dhe për të vijuar me procedurën e njohjes së licencës, vlerësohet përfundimi i procedurës së nisur për licencimin e shoqërisë “SOLE 24 DOOEL SHKUP–Dega në Shqipëri”, Degë e shoqërisë së huaj, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të përfundojë procedurën për licencimin e shoqërisë “SOLE 24 DOOEL SHKUP–Dega në Shqipëri”, Degë e shoqërisë së huaj, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI